

URDHËR
Nr. 190, datë 1.4.2019

**PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË VEPRIMTARISË DHE DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 22, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”,

URDHËROJ:

1. Zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Lorena Haxhiu, të ndjekë dhe të nënshkruajë çështjet që kanë të bëjnë me:

- a) hartimin dhe zbatimin e politikës shtetërore në fushën e rinisë;
- b) hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e rinisë;
- c) përmbushjen e objektivave të parashikuar në programin e Qeverisë, për pjesën që i përket rinisë;
- d) sigurimin e bashkëpunimit me organizma, institucione, donatorë dhe aktorë të tjerë, kombëtarë apo ndërkombëtarë, për realizimin e veprimtarive që synojnë përmbushjen e politikave dhe programeve për rininë;
- e) bashkërendimin dhe zbatimin e programeve, projekteve dhe veprimtarive rinore në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- f) mbështetjen dhe përfshirjen në veprimtari rinore të të rinjve me aftësi të kufizuara dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore nëpërmjet këtyre veprimtarive;
- g) bashkërendimin dhe monitorimin e ecurisë së punës së Shërbimit Kombëtar për Rininë, në rolin e institucionit përgjegjës për zbatimin e politikës shtetërore në fushën e rinisë;
- h) problematikat që parashtrihen nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë në Republikën e Shqipërisë;
- i) ushtrimin, në mungesë dhe me porosi të ministrit, të kompetencave në fushën e rinisë;
- j) përfaqësimin e Shqipërisë në bordin drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO);
- k) sigurimin e përfshirjes dhe përfaqësimit të Shqipërisë në projekte të veprimtari rinore në nivel ndërkombëtar;
- l) mbajtjen e marrëdhënieve me Këshillin e Evropës, si dhe përfaqësimin e vendit në Komitetin Drejtues Evropian për Rininë (CDEJ).

2. Zëvendësministri mund të kërkojë informacion me shkrim për çdo korrespondencë shkresore të administratës në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështjet në fushën e rinisë.

3. Ngarkohet zëvendësministri, që brenda 10 ditëve nga miratimi i këtij urdhri, të detajojë planin e punës me veprimet dhe afatet konkrete për përmbushjen e detyrave të përcaktuara më sipër. Plani i punës miratohet nga ministri.

4. Zëvendësministri, për veprimtarinë javore të kryer, i raporton me shkrim ministrit çdo të hënë të javës pasardhëse.

5. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrat e tjerë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështje të caktuara, që konvergojnë në fushën e përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendësministrave.

6. Ngarkohet zëvendësministri, znj. Lorena Haxhiu, për zbatimin e këtij urdhri dhe Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, për njoftimin e urdhrit, drejtorive të ministrisë dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini